Konflikti për pronën mes xhaxhait dhe nipit çon në përdorimin e armës

Shpërndaje



09:00 27/06/2022

Malësi e Madhe | Nga strukturat e Komisariatit të Policisë Malësi e Madhe, pas marrjes së njoftimit për kanosje me armë zjarri për motive pronësie, është organizuar dhe finalizuar operacioni policor i koduar "Prevention", për parandalimin e përshkallëzimit të këtij konflikti.

Si rezultat i këtij operacioni është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit S. K., 29 vjeç, banues në fshatin Gruemirë-Çezme, Malësi e Madhe. Ky shtetas, pasi është konfliktuar për motive pronësie me xhaxhain e tij, shtetasin Sh. K., 64 vjeç, e ka kanosur atë duke qëlluar në ajër me armë zjarri automatik.

Falë veprimeve të shpejta, shërbimet e Policisë kanë kapur dhe arrestuar në flagrancë 29-vjeçarin, duke parandaluar kështu përshkallëzimin e mëtejshëm të konfliktit.

Gjatë kontrollit të zonës, në vendin e quajtur "Grop Kuqe Bracaj" të fshatit Gruemirë-Çezme, Malësi e Madhe, u gjet dhe u sekuestrua në cilësinë e provës materiale arma e zjarrit me të cilën dyshohet se ka qëlluar në ajër shtetasi S. K.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprat penale "Kanosja" dhe "Mbajtja pa leje e armëve dhe e municionit"./*tvklan.al*

TË NGJASHME

Atentat mafioz në mes të lokalit në Athinë, vritet shqiptari dhe plagosen 2 të tjerë

20:55 18/12/2022

Gjykata e Lartë rrëzon Genc Tafilin

19:18 18/12/2022

Rreth 2 mijë denoncime çdo ditë në polici

14:51 18/12/2022

Vrasja e Edmond Papës, zbardhen pamjet e kamerave

14:43 18/12/2022

Pajisja që ndihmoi në zbardhjen e vrasjes së 2017-ës

14:38 18/12/2022

Atentati ndaj biznesmenit Dashamir Gjoka, ekstradohet nga Spanja edhe Morel Kërtalli

12:23 18/12/2022

Policia: 19 operacione të finalizuara në një javë

12:12 18/12/2022

Arrestohet punonjësi i Postës në Tropojë, shpallet në kërkim një tjetër

10:44 18/12/2022

Vinte baste sportive, vihet në pranga 19-vjeçari

09:31 18/12/2022

© 2022 TV Klan. All Rights Reserved.